



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

OPINIONI LIGJOR I AVOKATIT TË POPULLIT

NË CILËSINË E MIKUT TË GJYKATËS (AMICUS CURIAE)

për

GJYKATËN THEMELORE NË PRISHTINË

R. nr. 175/2024

lidhur me diskriminimin dhe shkeljen e dinjitetit të pjesëtarëve të komunitetit LGBTIQ+, si dhe padinë C.nr 2993/2024 të paraqitur më 1 mars 2024 në Gjykatën Themelore në Prishtinë

Prishtinë, më 17 tetor 2024

Qëllimi i opinionit ligjor

1. Ky opinion ligjor i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës i ka dy qëllime:
 - a. Në pjesën e parë të tij përqendrohet në bazën ligjore dhe mbrojtjen gjyqësore në rastet e diskriminimit.
 - b. Në pjesën e dytë, përqendrohet dhe analizon deklaratat e disa deputetëve lidhur me komunitetin LGBTIQ+, të shprehura në seancën plenare të datës 16 mars 2022, në të cilën është debatuar Projektkodi Civil, nr. 08/L-124.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit

2. Neni 132, paragrafi 1, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës autorizon Avokatin e Popullit të *“mbikëqyrë dhe të mbrojë të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet e paligjshme dhe jo të rregullta të organeve publike.”*
3. Neni 16 i Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në paragrafin 4, përcakton se: *“Avokati i Popullit ka kompetencë të kryejë hetim qoftë për të përgjigjur ndaj një ankese të paraqitur apo vetëiniciativë (ex officio), nëse nga gjetjet, provat dhe faktet e paraqitura në petition ose nga njohuritë e marra në mënyra të tjera, ka bazë për të rezultuar se autoritetet kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.”*
4. Neni 16, paragrafi 9, i Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, përcakton: *“Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në procedurat gjyqësore të lidhura me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi.”*
5. Përveç kësaj, vlen të përmendet edhe paragrafi 8 i nenit 16, i cili por përcakton se: *“Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit të drejtësisë. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe procedurat e tjera ligjore që zhvillohen para gjykatave, përveç rasteve kur ka vonesa në procedura.”*
6. Gjithashtu duhet të merret parasysh se me nenin 18, paragrafi 1.1. të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka përgjegjësi: *“1.1. të hetojë shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut dhe veprimet diskriminuese dhe të angazhohet për zgjidhjen e tyre. 1.2. të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandime për ndalimin e tyre, dhe kur është e nevojshme të shprehë mendimin e tij për qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse lidhur me këto raste.”*

MBROJTJA GJYQËSORE NGA DISKRIMINIMI

7. Avokati i Popullit e vlerëson si të rëndësishme që të sjellë parasysh aspektin procedural të trajtimit të një rasti të diskriminimit nga gjykatat, duke u bazuar në dispozitat e Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021 (LMD), i cili për nga disa aspekte dallon nga procedurat e zakonshme, e që në rastet e diskriminimit paraqet një ligj special.
8. LMD në nenin 13, përcakton se:
 1. *Çdo person ose grup i personave që ankohen se kanë qenë të diskriminuar mbi bazat e përmendura në nenin një (1) të këtij Ligji mund të paraqesin padi në gjykatën kompetente.*

2. Shoqatat, organizatat apo subjektet tjera juridike mund të iniciojnë apo përkrahin procedura ligjore në emër të parashtruesit, me marrjen e pëlqimit të tyre, për zhvillimin e procedurave administrative apo gjyqësore të parapara për zbatimin e obligimeve nga ky ligj.

9. Neni 14, paragrafi 3 i LMD përcakton se:

“Subjektet kanë mundësi të paraqesin padi për diskriminim sipas këtij ligji, jo më vonë se pesë (5) vjet nga dita që i dëmtuari merr dijëni për këtë shkelje”

10. Neni 16, paragrafi 9 i LMD përcakton se:

“Procedurat gjyqësore në rastet e diskriminimit duhet të trajtohen me urgjencë.”

11. Megjithëse mbrojtja gjyqësore nga diskriminimi mund të arrihet përmes mbrojtjes kushtetuese të të drejtave, procedurës civile, administrative, penale, ose të kundërvajtjes, në perspektivën krahasuese më së shpeshti parashikohet mbrojtja përmes procedurës civile.

12. Gjykata, në procedurën civile, kur konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore për mbrojtje, është e detyruar t'i ofrojë mbrojtje viktimës së diskriminimit. LMD në nenin 16, paragrafin 2 përcakton se: *Gjykata pasi që merr provat dhe argumentet relevante vërteton se i padituri ka kryer veprime apo mosveprimeve diskriminuese ndaj paditësit mund të vendos që:*

2.1. t'i ndalojë të paditurit kryerjen e veprimeve diskriminuese të cilat shkelin ose mund të shkelin të drejtën e paditësit, apo ta detyrojë të paditurin që t'i eliminojë të gjitha veprimet diskriminuese ndaj paditësit;

2.2. të kompensojë dëmin material ose jomaterial të shkaktuar nga shkelja e të drejtave të mbrojtura me këtë Ligj, sipas padisë për dëmshpërblim;

2.3. të urdhërojë masa të përkohshme konform dispozitave të ligjit përkatës mbi procedurën kontestimore (nëse paditësi e ka bërë të besueshme që e drejta e tij/saj për trajtim të barabartë është shkelur, dhe nëse është e nevojshme të urdhërojë një masë me synimin për të eliminuar rrezikun e dëmeve të pariparueshme, veçanërisht për shkeljet e rënda të të drejtës për trajtim të barabartë, apo me qëllim të parandalimit të dhunës);

2.4. të urdhërojë afatin kohor më të shkurtër për ekzekutim se sa është përcaktuar me ligjin përkatës mbi procedurën përmbartimore;

2.5. të publikojë në media vendimin gjyqësor, përmes të cilit vërtetohet shkelja e së drejtës për trajtim të barabartë.

13. Çdo person që pretendon që është viktimë e diskriminimit, ka të drejtë të parashtojë padi kundër të paditurit dhe t'i ndërmarrë të gjitha veprimet juridike në gjykatën kompetente. Sipas nenit 16, paragrafi 4 i LMD-së:

Kërkesat mund të paraqiten së bashku me kërkesat për mbrojtjen e të drejtave tjera, për të cilat vendoset në procedurë kontestimore, nëse të gjitha kërkesat janë në lidhje të ndërsjellë dhe nëse gjykata e njëjtë ka kompetencë lëndore për to, pa marrë parasysh nëse për ato kërkesa është përcaktuar vendimmarrje në procedurë të përgjithshme ose të veçantë kontestimore.

14. Sipas Nenit 12, paragrafi 4 i LMD:

“Shoqatat, organizatat apo subjektet tjerë juridik mund të iniciojnë apo përkrahin ankesat në emër të parashtruesit, me marrjen e pëlqimit të tyre, për zhvillimin e procedurave tek Avokati i Popullit.”

15. Sipas, nenit 13, paragrafi 2: *“Shoqatat, organizatat apo subjektet tjera juridike mund të iniciojnë apo përkrahin procedura ligjore në emër të parashtruesit, me marrjen e pëlqimit të tyre, për zhvillimin e procedurave administrative apo gjyqësore të parapara për zbatimin e obligimeve nga ky ligj.”* Ndërsa, sipas nenit 18 të LMD *“Rastet e diskriminimit të cilat prekin grupet e personave mund të inicohen nëpërmjet një veprimi grupor të ndërmarrë në emër të tyre nga një organizatë joqeveritare ose nga Avokati i Popullit, në raste të tilla, nuk kërkohet pëlqimi i anëtarëve të grupit.”*
16. Sipas nenit 16, paragrafi 3, të LMD: *“Pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë kundër vendimit të shkallës së parë në afat prej shtatë (7) ditësh në Gjykatën e Apelit sipas ligjit përkatës mbi procedurën kontestimore.”*
17. Sipas nenit 20, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të LMD:
 1. *Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin prova para organit administrativ apo gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.*
 2. *Barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.*
18. Avokati i Popullit vë theksin te zhvendosja e barrës së provës si një ndër karakteristikat e që e veçojnë procedurën në rastet e diskriminimit në procedurat civile dhe që dallon nga procedurat e zakonshme gjyqësore se kush është përgjegjës për vërtetimin e fakteve në një rast. Si rregull, në procedurat gjyqësore, barra e provës i takon paditësit (personi që sjell çështjen para gjykatës) për të provuar pretendimet e tij/saj. Megjithatë, në rastet e diskriminimit, pasi paditësi ka paraqitur një rast *prima facie* (prova fillestare të mjaftueshme) të diskriminimit, barra e provës i kalon palës së paditur. Paditësi duhet së pari të paraqesë prova që sugjerojnë se ka ndodhur diskriminimi. Kjo mund të përfshijë faktet se pala paditëse ka ndonjë karakteristikë të mbrojtur të përcaktuar me nenin 1 të LMD, se ka pësuar nga një veprim të pafavorshëm nga ana e autoriteteve (si p.sh. pushimi nga puna ose ulja në detyrë) dhe se ka disa tregues se veprimi i tillë ka të bëjë me karakteristikat e mbrojtura (si p.sh. orientimi seksual). Pasi paditësi paraqet një çështje *prima facie*, barra e provës i kalon palës së paditur. Më pas, i padituri duhet të japë një arsye legjitime për veprimin e kryer ndaj paditësit. Pala e paditur duhet të tregojnë se veprimi i ndërmarrë është bazuar në faktorë që nuk kanë lidhje me diskriminimin. Ky ndryshim në barrën e provës është krijuar për ta bërë më të lehtë për paditësit që të kundërshtojnë praktikat diskriminuese dhe për gjykatat të zbulojnë arsyet e vërteta pas veprimeve të caktuara. Provat e drejtpërdrejta të diskriminimit shpesh janë të vështira për t'u gjetur, kështu që sapa paditësi të sigurojë prova të mjaftueshme për të pretenduar diskriminim, përgjegjësia i takon të paditurit që të provojë të kundërtën.

PËRMBLEDHJE E FAKTEVE TË RASTIT

19. Avokati i Popullit, bazuar në nenin 16. paragrafi 1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, më 1 mars 2024, ka pranuar ankesë kundër Kuvendit të Republikës së Kosovës që lidhet me diskriminimin dhe shkeljen e dinjitetit të personave LGBTIQ+ gjatë seancës

plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtur më 16 mars 2022. Ankesa është paraqitur në emër të organizatave të mëposhtme joqeveritare: Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut e Kosovës (YHR), Qendra për Barazi dhe Liri, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, Mbrojtësit e të Drejtave Qytetare, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, të cilat me autorizim përfaqësohen nga Marigona Shabiu nga Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut e Kosovës.

20. Duke marrë parasysh që ankuesit, më 1 mars 2024, të njëjtën ditë kur kanë paraqitur ankesë tek Avokati i Popullit, kanë paraqitur edhe padinë (C.nr 2993/2024) në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Avokati i Popullit pas analizimit të rrethanave të rastit ka vendosur t'i paraqesë kësaj gjykate mendimin e tij në cilësinë e mikut të gjykatës.
21. Më 16 mars 2022, Kuvendi i Republikës së Kosovës, mbajti një seancë plenare ku ndër të tjera, po zhvillonte edhe shqyrtimin e parë të Projektkodit Civil, nr. 08/L/124. Dispozita që nxiti diskutimin kontradiktor ndërmjet anëtarëve të Kuvendit të Kosovës ishte neni 1138, paragrafi 2, i Projektkodit Civil, që parashikon se *“Lejohen bashkësitë e regjistruara civile ndërmjet personave të së njëjtës gjini. Kushtet dhe procedurat rregullohen me ligj të veçantë.”*
22. Në këtë seancë, u shprehen deklaratat negative ndaj personave LGBTIQ+ nga disa deputetë, të cilët jo vetëm që propagandonin hapur “familjen natyrale” dhe “ruajtjen e llojit” dhe “traditës”, por edhe verbalizonin paragjykime ndaj çifteve të të njëjtës gjini. Sipas tyre, Kodit i ri do të rrezikonte “moralin publik” dhe do të përfaqësonte “të pangopshmërinë seksuale”, “degjenerimin moral”, “sëmundjen”, “shkatërrimin”, sjelljen që është “në kundërshtim me natyrën njerëzore”, “shkeljen e shenjtërisë së familjes”, “përfaqëson një akt që seriozisht dëmton shëndetin publik, duke u bërë shkak për sëmundje të rënda dhe të pashërueshme, si HIV/AIDS-i”, dhe që në fund rezulton në “traumë shoqërore”.
23. Para diskutimit parlamentar, disa deputetë u shfaqën edhe në publik me deklaratat dhe pretendime se pse nuk duhet të votohet për Projekt Kodin Civil. Këto qëndrime ngjallën komente negative në rrjetet sociale dhe në opinionin publik, të cilat më tej shpërfaqën narrative dhe qëndrime homofobe.
24. Organizatat e shoqërisë civile reagues kundër gjuhës që përdorej ndaj komunitetit LGBTIQ+ gjatë debatit për Projekt Kodin Civil. Në reagimet e tyre, ato theksuan se diskriminimi dhe stigmatizimi shoqëror dëmtojnë mirëqenien psikologjike, fizike, sociale dhe ekonomike të personave LGBTIQ+.

Opinion i Avokatit të Popullit

25. Legjisllacioni përkatës për mbrojtje nga diskriminimi përcakton se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se askush nuk duhet të diskriminohet mbi bazën e statusit personal siç është, ndër të tjera, edhe orientimi seksual, që do të thotë se orientimi seksual është një karakteristikë e mbrojtur e përcaktuar me nenin 1 të LMD.
26. Duke marrë parasysh objektin e kësaj ankese, Avokati i Popullit thekson se është e nevojshme të përcaktohet nëse qëndrimet dhe deklaratat e bëra nga deputetët e përmendur më 16 mars 2022, në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, gjatë shqyrtimit të parë të Projektkodit Civil, nr. 08/L-124, përbëjnë shkelje të dispozitave të LMD-së. Respektivisht, nëse qëndrimet dhe deklaratat e bëra nga këta deputetë përbëjnë

shkelje të dinjitetit të personave ose grupit të personave mbi bazën e karakteristikës së tyre personale, konkretisht orientimit seksual dhe nëse këto deklarata krijojnë një ambient armiqësor, poshtërues dhe fytes për pjesëtarët e komunitetit LGBTIQ+ dhe nëse këto deklarata mund të konsiderohen si gjuhë urrejtjeje.

27. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 3 garanton barazinë para ligjit, në nenin 7 përcakton vlerat ku, në mes tjerash, renditen të drejtat dhe liritë e njeriut dhe mosdiskriminimi si dhe me nenin 24 garanton që të gjitha janë të barabartë para ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet, në mes tjerash, në bazë të orientimit seksual.

28. Avokati i Popullit rikujton betimin solemn të deputetëve të përcaktuar me nenin 10 të Rregullores së Kuvendit, me tekstin si në vijim:

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë shtetasve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e sovranitetit, tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit. Betohem!”

29. Betimi në respektimin e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë dhe për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në përputhje me ligjet e vendit i obligon deputetët që të zbatojnë dhe të respektojnë Kushtetutën dhe legjislacionin për mbrojtje nga diskriminimi edhe të shtetasve të Republikës së Kosovës që i përkasin komunitetit LGBTIQ+.

30. Rekomandimi CM/Rek(2010)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 31 mars 2010 në takimin e 1081-të të Zëvendës Ministrave), jap një numër rekomandimesh: duke rikujtuar se, në mes tjerash, lesbiket, homoseksualët, biseksualët dhe transeksualët kanë qenë për shekuj me radhë dhe vazhdojnë ende të jenë objekt homofobie, transfobie dhe formave të tjera të intolerancës dhe diskriminimit edhe brenda familjes së tyre, duke përfshirë kriminalizimin, marxhinalizimin dhe dhunën, për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, dhe duke pranuar se nevojiten masa specifike për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut të këtyre personave; Duke pasur parasysh se jurisprudenca e GjEDNj dhe juridiksione të tjera ndërkombëtare të cilat e konsiderojnë orientimin seksual shkak të ndaluar për diskriminim dhe të cilat kanë kontribuar për çuarjen përpara të mbrojtjes së të drejtave të personave transeksualë; Duke kujtuar që në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës, çdo dallim në trajtim në mënyrë që të mos jetë diskriminues, duhet të ketë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, pra duhet të ndjekë një qëllim legjitim dhe duhet të përdorë instrumente që janë përpjesëtimisht të arsyeshme me qëllimin e ndjekur; Duke mbajtur parasysh se as parimi i vlerave kulturore, tradicionale ose fetare, dhe as rregullat e një “kulture dominuese” nuk mund të përdoren si shkaqe për justifikimin e fjalimeve të urrejtjes apo të asnjë forme tjetër diskriminimi, duke përfshirë dhe orientimin seksual ose identitetin gjinor;

31. Avokati i Popullit, në kontekstin e rastit, ka parasysh rëndësinë e lirisë së mendimit dhe shprehjes. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit thekson se çdo individ ka të drejtë të shprehë mendimin dhe qëndrimet e tij personale, gjë që përbën bazën e çdo shoqërie të

lirë demokratike. Megjithatë, e drejta për lirinë e fjalës, pavarësisht mënyrës së shprehjes dhe publikimit të ideve dhe qëndrimeve, nuk duhet të jetë një justifikim për diskriminim. Prandaj, shprehja e qëndrimeve dhe bindjeve që shkelin dinjitetin e personave ose grupit të personave dhe dëmtojnë reputacionin, si dhe të drejtat e garantuara të të tjerëve, nuk mund të justifikohet me të drejtën për lirinë e shprehjes.

32. Këto qëndrime dhe deklaratat kanë një peshë të veçantë kur merret parasysh se deputetët e Kuvendit të Kosovës janë pjesë e një institucioni që është organi më i lartë përfaqësues dhe bartësi i pushtetit kushtetues dhe legjislativ në vend dhe që është jashtëzakonisht i rëndësishëm për vendosjen e sistemit demokratik dhe që përfaqëson bazën për vendosjen e sundimit të ligjit, mbikëqyrjen e proceseve të qeverisjes dhe respektimin e instrumenteve dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
33. Avokati i Popullit e ka parasysh se deputetët kanë imunitet lidhur me deklaratat e tyre në parlament, megjithatë ky imunitet do të duhej të shqyrtohej kur bëhet fjalë për deklaratat që përmbajnë gjuhë të urrejtjes dhe diskriminim.
34. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka trajtuar raste që përfshijnë fjalime diskriminuese të përdorura nga zyrtarë publikë, duke përfshirë politikanë dhe përfaqësues të qeverisë. Këtu janë disa pika dhe parime kryesore që rrjedhin nga jurisprudenca e GJEDNJ:
 - a. GJEDNJ njeh rëndësinë e lirisë së shprehjes, duke përfshirë edhe lirinë e shprehjes për zyrtarët publikë, si një e drejtë themelore sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute dhe mund t'i nënshtrohet kufizimeve, veçanërisht kur bëhet fjalë për të folur që mund të dëmtojë të drejtat ose interesat e të tjerëve.
 - b. GJEDNJ gjithashtu mbështet parimin e mosdiskriminimit sipas nenit 14 të KEDNJ, i cili ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të garantuara nga Konventa.
 - c. GJEDNJ bën dallimin në mes kritikës legjitime ose shprehjes së mendimit dhe gjuhës së urrejtjes. Gjuha e urrejtjes, veçanërisht kur përdoret nga zyrtarët publikë, mund të dëmtojë kohezionin social dhe të cenojë dinjitetin njerëzor dhe nuk gëzon mbrojtje sipas nenit 10 nëse tejkalon kufijtë e lejueshëm të lirisë së shprehjes.
 - d. Konteksti në të cilin shfaqet fjalimi diskriminues është vendimtar. Deklaratat e bëra nga zyrtarët publikë kanë peshë dhe mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në diskursin publik dhe qëndrimet shoqërore. Prandaj, deklaratat të tillë mund t'i nënshtrohet një shqyrtimi dhe llogaridhënieje më të rreptë.
 - e. GJEDNJ thekson rëndësinë e mjeteve juridike efektive për viktimat e deklaratave diskriminuese. GJEDNJ pret që shtetet të sigurojnë mekanizma për të adresuar gjuhën e urrejtjes dhe për të siguruar llogaridhënie, duke përfshirë masat ligjore, gjyqësore dhe administrative.
35. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit sjell parasysh disa shembuj që ilustrjnë qasjen e GJEDNJ-së ndaj gjuhës së urrejtjes nga zyrtarët publikë, duke theksuar balancën ndërmjet lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes nga diskriminimi dhe nxitja e urrejtjes. GJEDNJ në vazhdimësi ka mbështetur dënimet dhe sanksionet kundër zyrtarëve publikë, deklaratat e

të cilëve mendohej se përbënin gjuhë të urrejtjes, duke pohuar rëndësinë e nxitjes së tolerancës dhe mbrojtjen e grupeve të cënueshme nga diskriminimi.

- a. Rasti *Eon kundër Francës* (Nr. 26118/10) ka të bëjë me një kryebashkiak në Francë i cili bëri komente antisemite gjatë një takimi publik. Ai u dënua sipas ligjit francez për nxitje të urrejtjes racore. GJEDNJ ka konstatuar se komentet e kryetarit nuk mbroheshin nga liria e shprehjes dhe se ato përbënin gjuhë të urrejtjes.
 - b. Rasti *Feldek kundër Sllovakisë* (Nr. 29032/95) ka të bëjë me një deputet sllovak i cili bëri komente nënçmuese për komunitetin rom në një artikull gazete. GJEDNJ u shpreh se komentet përbënin gjuhë të urrejtjes dhe shkelnin ndalimin e diskriminimit sipas nenit 14 të KEDNJ-së, të ndërlidhur me nenin 10 (liria e shprehjes).
 - c. Rasti *Ernst kundër Belgjikës* (Nr. 33400/96) ka të bëjë me një politikan belg, i cili gjatë një interviste televizive bëri deklaratat që mohonin Holokaustin. Ai u dënua sipas ligjit belg për nxitje të urrejtjes racore. GJEDNJ mbështeti vendimin e gjykatës belge, duke theksuar rëndësinë e luftimit të racizmit dhe intolerancës.
 - d. Rasti *Féret kundër Belgjikës* (Nr. 15615/07) ka të bëjë me Lideri i një partie politike belge i cili shpërndau fletëpalosje që target i kishin emigrantët dhe që përmbanin deklaratat ksenofobike. Ai u dënua sipas ligjit belg për nxitje të diskriminimit dhe urrejtjes racore. GJEDNJ mbështeti vendimin e gjykatës belge, duke theksuar nevojën e mbrojtjes së individëve nga fjalimet diskriminuese.
36. Avokati i Popullit vlerëson se liria e fjalës, shprehjes dhe informimit nuk duhet të jetë një justifikim për asnjë lloj diskriminimi dhe nënvlerësimi për ndonjë karakteristikë personale, as për promovimin e paragjyqimeve dhe krijimin e një mjedisi armiqësor dhe fyes për një grup të caktuar njerëzish. Gjithashtu, liria e shprehjes nuk mund të përdoret si justifikim për gjuhën e urrejtjes.
37. Avokati i Popullit vlerëson se deklaratat e përfaqësuesve të popullit, të cilët përcjellin mesazhe dhe formësojnë qëndrimet e opinionit publik, janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe prandaj deklaratat e tyre nuk duhet të mbështesin paragjykimet, stereotipet dhe modelet e tjera të papranueshme shoqërore. Për këtë arsye, të gjithë zyrtarët shtetërorë dhe organet publike kanë një përgjegjësi të veçantë dhe një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në promovimin e tolerancës, promovimin e të drejtës për dallim dhe krijimin e një shoqërie ku të drejtat e të gjithëve respektohen pa diskriminim.
38. Avokati i Popullit vlerëson se deklaratat e deputetëve të bëra më 16 mars 2022, gjatë debatit në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, gjatë shqyrtimit të nenit të Projektkodit Civil, nr. 08/L-124, lidhur me nenin 1138, paragrafi 2, janë diskriminuese, shkelin dinjitetin e personave LGBTIQ+ duke krijuar një mjedis poshtërues dhe fyes ndaj tyre dhe, duke u bazuar në praktikën e GjEDNJ, përbëjnë gjuhë të urrejtjes ndaj komunitetit LGBTIQ+.

Me respekt,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit